

SPECIFIKIMET TEKNIKE

PER VULAT E SIGURISE DHE TELIT PER VULA SIGURIE

PER VULAT E SIGURISE DHE TELIT PER VULA SIGURIE

1. KERKESAT E PERGJITHSHME

Ky pershkrim perfshin projektimin, prodhimin, testimin dhe levrimn e vulave te sigurie dhe telit per vulat e sigurise qe sherbejne per vulosjen morseterise se matesit elektrik te rrymes alternative nje dhe tre fazor. Kjo vule sigurie do te perdoret edhe per vulosjen ne teresi te sistemit te matjes se energjise elektrike qe perfshin jo vetem matesin elektrik, por edhe transformatoret e rrymes, transformatoret e tensionit dhe bokset individuale me mates elektrik.

Vulat e sigurise sherbejne per te mbrojtur matesat e energjise nga nderhyrjet nga jashte.

2. KERKESAT E DETYRUESHME

Eshte e detyrueshme qe furnizuesi te siguroje dokumentat e meposhtme:.

- a) Certifikatat e prodhuesit ISO 9001 ose ekuivalente te tyre
- b) Te dhenat teknike sic kerkohen ne specifikimet teknike.
- c) Raportet e testeve sipas specifikimeve teknike
- d) Skicat me dimensione
- e) Te kete autorizim prodhuesi

3. APLIKIMI

Vula e sigurise duhet te jene ne perputhje me kerkesat teknike te pershkruara ne kete dokument. Drejtoria e Pergjithsme e Metrologjise (DPM) ka kryer miratimin e tipit te vules se sigurise qe do te perdoret nga OSHEE sha per vulosjen e morseterise se matesit elektrik.

OSHEE kerkon te ofrohet e njejta vule e cila duhet te kete parametrat teknike, dimensionet dhe paraqitjen e vules se miratuar paraprakisht nga DPM.

Nese ofruesi paraqet nje vule sigurie e cila nuk eshte e njejte me vulen e miratuar me pare dhe qe perdoret aktualisht nga OSHEE, propozimi i tij do te perjashtohet dhe nuk do te vleresohet.

Tipi i vule duhet te miratohet Nga DPM kur te behet dorezimi.

4. KOHEZGJATJA MESATARE E SHERBIMIT

Vula e sigurise duhet te kete te pakten 10 vjet te jetegjatesise se punes.

5. INSTALIMI

Vendosja e vules se sigurise nuk kerkon asnje mjet special per instalim. Vula do te qendroj ne ambjent te jashtem dhe duhet ti rezistoje kushteve te temperatures sikurse parashikohet ne keto specifikime teknike.

6. STANDARDET E REFERENCES

Vula e sigurise duhet te jete ne perputhje me kerkesat e zbatueshme te standardeve S S H / I S O / I E C / E N ose ekuivalenteve te tyre. Ne rast se kerkesat e ketyre specifikimeve do te jene ne konflikt me standardet e mesiperme, do te mbizoterojne specifikimet teknike te ketij dokumenti.

KUSHTET E SISTEMIT ELEKTRIK

Specifikime Teknike – Per Vulat e Sigurise dhe Telit per Vulat e Sigurise

a)	Te dhenat e sistemit	Njesite	Vlera
	Tensioni i larte i sistemit	kV	0.6
	Tensioni nominal	V	380/220
	Frekuenca	Hz	50
	Numri i fazave		3 fazor/4 fije
	Sistemi i tokezimit		Tokezim solid
b)	Kushtet atmosferike		
	Temperatura maks. e mjedisit		50° C
	Temperatura min. e mjedisit		-40° C
	Lageshtia relative maks.		90%
	Lartesia maks. mbi nivelin e detit		1500m
	Ndotja		Mesatare

7. KERKESAT TEKNIKE PER VULAT E SIGURISE

Vula e sigurise duhet te kete te gjithë elementet e sigurise per te mbrojtur sistemin e matjes se energjise elektrike nga nderhyrjet e personave te tjere.

Vula e sigurise duhet te prodhohet prej fabrikimit me linje automatike prodhimi

7.1 Pershkrimi i vules se sigurise

Tipi i vules qe kerkohet te levrohet eshte e tipit ROTO SEAL e realizuar me dy pjese , njera prej te cilave perben pjesen e palevisshme dhe quhet statori i vules kurse pjesa tjeter eshte e levizshme dhe quhet rotor i vules. Trupi i vules (statori), ka nje mekanizem te brendshem mbylljeje qe pranon dhe siguron pjesen e brendshme(rotorin) se bashku me telin e viaskuar te vules

Pas montimit, pjesa e brendshme (rotori) dhe trupi (statori), perputhen dhe nuk krijojne boshllek i cili mund te lejoje futjen e mjeteve te vogla si p.sh maje thike apo mjete te tjera te mprehta (shih foton ilustruese).

Vula eshte e montueshme me nje proces te vetem pa nevojën e mjeteve ndihmese. Vula eshte projektuar per nje perdorim dhe nuk hapet aksidentalisht.

Cdo perpjekje per te nderhyre me ane te ushtrimit te nxehtesise, forces mekanike (duke futur nje mjet, duke e shpuar, perkulur apo terhequr) apo kimikateve (tretesve) eshte e dallueshme nepermjet shenjave qe le.




Foto ilustruese

7.2 Ngjyra e vules se sigurise

Statori i vules se sigurise do te jete me ngjyre transparente per te identifikuar nderhyrjet e mundshme nga jashte, kurse pjesa tjeter eshte e levizshme (rotori) realizohet me ngjyre materiali te ndryshme.

Specifikime Teknike – Per Vulat e Sigurise dhe Telit per Vulat e Sigurise

- Referohet qe per vulat e qe perdor OSHEE, per vulosjen e sistemit te matjes se energjise elektrike pjesa e rotorit te kete ngjyre blu.

7.3 Pjesa e shkrimeve ne vulen e sigurise

Pjesa e shkrimeve te vules se sigurise realizohet si trup i vetem sebashku me statorin.

Fusha e vules ku realizohen shkrimet eshte me ngjyre te zeze per te identifikuar me mire shkrimet mbi te.

Ne pjesen e shkrimeve do te shenohen keto element:

- Emri i kompanise "OSHEE" per vulat ne perdorim nga OSHEE
- Numri serial i vules i cili eshte unik, me 8 shifra.
- Vula e sigurise do te jete me barcode linear nje dimensional ID (Code 128 barcode) i cili tregon numrin serial te vules se sigurise. Barcode duhet te jete i gdhendur me laser dhe i qendrueshem ne trupin e vules duke siguruar mos fshirjen e tij nepermjet ferkimit apo formave te ngjashme.
- Te gjitha numrat serial jane me gdhendje te perhershme printim me laser, me ngjyra qe kane nje kontrast te larte kundrejt ngjyres se trupit, te cilat nuk mund te manipulohen nga falsifikuesit dhe jane te qendrueshme nga agjentet atmosferike.

Per efekt sigurie 4 shifrat e fundit te numrit serial te vules korespondojne me 4 shifrat e gdhendura me lazer ne rotorin e vules.

Bishti i rotorit eshte nje element sigurie i cili vete-keputet ne procesin e vulosjes gjate ushtrimit te forces ne mbledhjes se telit.



Ne se furnizuesi ofron vule sigurie me tregues te ndryshem me keto kerkesa teknike athere propozimi i tij do te perjashtohet dhe nuk do te vleresohet.

7.4 Dimensionet e vules se sigurise

Nje pjese e rendesishme perben edhe dimensionet e vules ne teresi. Vula do te sherbej per vulosjen e matesave te energjise elektrike dhe pjesa kryesore e tyre jane te instaluar edhe ne bokse kolektive. Per masat e kufizuara te vete bokseve kolektive, bejne qe matesat elektrike te jene shume afer me njeri-tjetrin prandaj edhe hapësira midis matesave elektrik brenda boksit kolektiv eshte e kufizuar.

Ne cdo mates elektrike vendosen minimalish dy vula sigurie ne morseterine e tij, pasi nepermjet procesit te bashkevulosje, nje vule vendoset edhe prej subjekti te autorizuar qe keyen testimin e matesit elektrik dhe bashkevulos morseterine e matesir sebashku me operatorin e OSHEE. Meqenese hapësira midis matesave ne boks eshte e kufizuar dhe ne mates vendoset me shume se nje vule sigurie per morseterine e matesit, athere projektimi i vules me permasa sa me te vogla, por duke plotesuar te gjitha kerkesat teknike te pershkruara ne specifikimet teknike, mer nje rendesi te madhe.


Gjithashtu, trupi i statorit duhet te jete sa me kompakt dhe i shkurter pasi vulat e sigurise me trup te lart, manipuohen me lehte nga abuzuesit e energjise elektrike.

Ne meshtetje edhe te tipit te vules se sigurise qe DPM ka miratuar per OSHEE, rekomandohet qe qe vula e sigurise te kete keto dimensionet emeposhtme :

- Diameter i jashtem i statorit 15 mm
- Lartesia e statorit te vules 11 mm.

Specifikime Teknike – Per Vulat e Sigurise dhe Telit per Vulat e Sigurise

- Gjeresia e pjeses se shkrimeve 22 mm
- Dimensionet e pjeses se vules qe perdoret per shkrime eshte 8 x 20 mm.
- Gjeresia e vules sebashku me bishtin rrotullues per vendosjen e saj 21 mm.
- Lartesia e vules sebashku me pjesen e shkrimeve 28 mm
- Vula ka dy vrime per kalimin e telit i cili rekomandohet te jete me diameter 0.66-0.9 mm.



Trupi i rotorit qendron brenda statorit ne forme te qendrueshme dhe ka nje patente te vogel qe siguron qendrueshmeri ne pozicionin e tij dhe pengon daljen jashte rotorit.

Niveli siperm i siperfaqes se rotorit nuk duhet te jete i njejt me nivelin e buzeve te statorit.

Pjesa e brendshme (rotori) eshte "bllokuar" nga nje kapak i sigurise i cili eshte salduar ne menyre ultrasonike mbi trupin e vules(statori).

Ne se furnizuesi ofron vule sigurie me tregues te ndryshem me keto kerkesa teknike athere propozimi i tij do te perjashtohet dhe nuk do te vleresohet.

7.5 Qendrueshmeria e vules se sigurise ndaj temperatures

Vula e sigurise duhet te funksionoj shume mire dhe te ruaj cilesite e saj teknike edhe ne kushte ekstreme te ambientit.

Ekspierenca e punes ka deshmuar se persona abuzues qe demtojne vulat e sigurise me qellim te manipulimit te matesit elektrik, duke perdorur burime nxehtesie nga jashte.

Prandaj nga ana jone kerkohet qe vula e sigurise te ruaj karakteristikat e saj dhe te mos deformohet per diapazon te temperatures -40°C - +120°C.

Specifikime Teknike – Per Vulat e Sigurise dhe Telit per Vulat e Sigurise

Ne se furnizuesi ofron vule sigurie me tregues te ndryshem me keto kerkesa teknike atehere propozimi i tij do te perjashtohet dhe nuk do te vleresohet.

7.6 Materialet qe perdoren per vulen e sigurise

- Statori realizohet me material i cilesise se larte Polycarbonate transparent dhe eshte i qendrueshem ndaj UV
 - Rotori realizohet me material i cilesise se larte Acetal dhe eshte i qendrueshem ndaj UV
- Perberesit e ndryshem te vules nuk plasariten, nuk deformohen apo nuk cgjyrosen per shkak te ndryshimeve atmosferike.

8. PAKETIMI I VULAVE TE SIGURISE

Paketimi do te jete sipas standarteve ne qese plasmasi te cilat futen ne kuti kartoni. Kutia duhet te stampohet per te qene e sigurt. Çdo kuti kartoni duhet te kete etiketen me informacionin e meposhtem. 100 qese me vula vendosen ne nje kuti te vecante mbi te cilen vendosen keto informacione:

- Emri i klientit OSHEE
- Numrin serial ne formen e barkodit
- Sasine ne cope
- Modelin e vulave

Paketimi do te behet sipas kerkeses.


9. TESTIMI I VULAVE TE SIGURISE

Testet do te kryhen sipas standarteve te pershkruara ne seksionin t " STANDARTET E REFERENCES" ose standarteve ekuivalente.

10. TEL PER VULAT E SIGURISE

Teli i vules se sigurise duhet te jete prej material celiku 304L, ose ekuivalent, i perbehet nga keta element:

- Percjelles i celiku i qendror me diameter 0.3 +/- 0.02 deri 0.5 +/- 0.02 mm
- Percjelles i celiku rrethues me diameter 0.13 +/- 0.02 mm



11. PAKETIMI I TELIT PER VULAT E SIGURISE

Teli i vulave te sigurise do te paketohehet ne rula me nje gjatesi totale afersisht prej 100 ml .

Drejtoria Rajonale Tiranë, për realizimin e këtyre procedurave duhet të mbështetet në Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar dhe VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

ADMINISTRATOR I OSSH SH.A
Blendian DALIPI

Konceptoi: I.Sulejmani
Miratoi: . R.Haxhia
Konfirmoi: A. Ibrahim

E. Avdulaj
E.Bajollari
Xh.Kazaferi